


VLERËSIMI PARANDALUES I KORRUPSIONIT NË PROJEKTLIGJIN PËR INVESTIMET E HUAJA DIREKTE NË SHQIPËRI

Ndërlidhja mes sigurisë kombëtare dhe IHD-ve ka të bëjë me gjetjen e një ekuilibri. Nga njëra anë, IHD-të janë thelbësore për nxitjen e ekonomisë së Shqipërisë dhe përmbushjen e nevojave të saj kapitale, të cilat janë thelbësore për zhvillimin. Nga ana tjetër, duhen marrë masa të kujdesshme që investimet e huaja të mos çenojnë sovranitetin e vendit apo kontrollin mbi sektorët e ndjeshëm.



Fluksi i IHD-ve në Shqipëri, Banka Botërore

Investimet e huaja direkte (IHD) në Shqipëri kanë njohur një rritje të ndjeshme në vitet e fundit, duke sjellë përfitime të rëndësishme për ekonominë. Ato luajnë një rol kyç në transferimin e teknologjive, përmirësimin e konkurrencës lokale dhe nxitjen e zhvillimit ekonomik. Megjithatë, krijimi i mekanizmave të duhur për menaxhimin e IHD-ve është i rëndësishëm.

➤ **Projektligji i propozuar duhet përmirësuar për të siguruar që mekanizmat e screening të parandalojnë hapësirën për korrupsion dhe të mos çenojnë sigurinë kombëtare.**

**RISQET
NGA IHD**



Bashkimi i firmave të mëdha

Blerja e firmave vendase

Mungesa e greenfields

Risk Ekonomik

Risk Politik

Risk Kibernetik

Risk Mjedisor

Korrupsion



**INSTRUMENTET PËR
MENAXHIMIN E RISKUT**



Kufijtë e pronësisë së huaj

Pronësimi shtetëror i aktiveve të ndjeshme*

Autorizimi administrativ

Licensimi

Krijimi ose regjistrimi i ndërmarrjeve

Mekanizmat e shqyrtimit të investimeve

*Aktivitete që përfshijnë rreziqe me pasojë të rëndësishme nëse keqpërdoren ose kontrollohen nga entitete të jashtme

- ⚠️ Nuk janë respektuar standardet e transparencës dhe konsultimit publik
- ⚠️ Mungon publikimi i projektligjit në faqen zyrtare të Kuvendit
- ⚠️ Projektligji nuk përfshin dispozita të detajuara që përcaktojnë procedurat, afatet kohore dhe kriteret teknike për shqyrtimin e IHD-ve
- ⚠️ Në projektligj përdoren terma të paunifikuar, të papërkufizuar dhe në disa raste të paqartë.



Sugjerime për Përmirësimin e Projektligjit dhe Parandalimin e Korrupsionit

- ⇒ Sugjerohet që përkufizimi për 'Mekanizmin e shqyrtimit' të hiqet nga Neni 2 pasi krijon paqartësi
- ⇒ Sugjerohet riformulimi i plotë i Nenit 9 'Procedura e autorizimit', veçanërisht në lidhje me afatet dhe organet kompetente të shqyrtimit të aplikimit
- ⇒ Sugjerohet të sqarohet cili institucion e përgatit raportin dhe kujt ia paraqet
- ⇒ Sugjerohet që Neni 17 'Kundërvajtjet administrative' të rishikohet, pasi është e papranueshme që AIDA të vendosë gjoba për veten
- ⇒ Sugjerohet që projektligji të identifikojë dhe adresojë rreziqet e mundshme për sigurinë dhe rendin publik, duke shmangur pengesat e panevojshme për investimet legjitime



Kjo veprimtari u realizua si pjesë e projektit: "Rritja e llogaridhënies së qeverisë përmes një parlamenti më të përgjegjshëm," financuar nga FCDO përmes Ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar në Tiranë.